



Z. Ervin Shameti është emëruar pranë Institutit të Statistikave në vitin 1998 dhe gjatë karrierës së tij në INSTAT ka mbuluar disa detyra. Aktualisht Z. Shameti mban pozicionin e drejtorit në Drejtorinë e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit. Më parë ai ka punuar si specialist pranë Sektorit të Demografisë dhe më pas si përgjegjës në Sektorin e Hartografisë dhe Sistemeve të informacionit gjeografik (GIS).

Z. Shameti është diplomuar në ekonomi në vitin 1997 në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Në vitin 2016 ai ka kryer studimet pasuniversitare pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës, në degën “Gjeografi”, duke përfunduar me sukses masterin shkencor me specialitet në “Gjeografinë Humane”.

Gjatë karrierës së tij pranë Institutit të Statistikave z. Shameti është angazhuar në shumë aktivitete madhore si CENS-et e viteve 2001 dhe 2011. Ai ka dhënë kontribut në planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve në drejtimin e njësive të gjeoinformacionit dhe logjistikës, por gjithashtu dhe në publikimin e rezultateve apo analizat e thelluara.